

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-262/15**

**Prishtinë,  
25 Prill 2018**

Në çështjen juridike të:

**G. B.**

Ul. "Aleksinacka", 15  
18000 Nis  
Srbija

**Pala Ankuese**

Kundër

**Sh. E.**

**Pala Përgjegjëse**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islam, kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/263/2014 të datës 21 Tetor 2014 (lënda e regjistruar me numrin KPA06714), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me 25 Prill 2018, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e G. B, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/263/2014, të datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP, me numrin KPA06714.
2. Priset Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/263/2014, i datës, 21 Tetor 2014, për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP, me numrin KPA06714.
3. Bazuar në nenin 198.1 të Ligjit Nr.03/L006, të Procedurës Kontestimore, kërkesa e G. B, me numrin KPA06714, hedhet për shkak të mungesës së juridiksionit të KKPK-së.

### Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Më 26 Shkurt 2007, G. B. (në tekstin e mëtejshëm: Pala Ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) me të cilën kërkon të drejtën e shfrytëzimit dhe ri posedimit e banesës dy dhomëshe e cila gjendet në Lipjan, rruga "Vëllezërit Aksic" nr. 12, në katin e IV, në sipërfaqe prej 67,80 m<sup>2</sup> (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Sipas Palës Ankuese, humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar kishte ndodhur me 12 Qershor 1999, si rezultat i rrethanave gjatë viteve 1998/1999 në Kosovë.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, Pala Ankuese kishte dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
  - Aktgjykimin Nr. GZ.nr.99/95, të datës 24 Shkurt 1995, me të cilin Gjykata e Qarkut kishte konfirmuar Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ku i padituri I.E. ishte obliguar të liroj pronën e kërkuar. Paditëse ishte Fabrika "Stanoje Aksic", si bartëse e të drejtës së banesës,
  - Vendimin për ndarje në shfrytëzim të përkohshëm Nr. 232, të datës 17 Maj 1995, me të cilin Palës Ankuese iu ishte ndarë prona e kërkuar në shfrytëzim të përkohshëm nga Këshilli Drejtues i Fabrikës "Stanoje Aksic" në Lipjan,
  - Procesverbali i datës 03 qershor 1995, me të cilin BDN, kishte dëbuar I. E. duke e dorëzuar pronën e kërkuar në posedim të Palës Ankuese.
  - Pagesa e Rrymës Nr. 041324 e datës 25 (muaji dhe viti i pa lexueshëm) nga e cila vërtetohet pagesa e pjesshme e rrymës elektrike për vitin 1999-2001, në emër të Palës Ankuese,
3. Më 06 Gusht 2007, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë identifikimin e pronës së kërkuar dhe në momentin e vizitës prona rezultoi të ishte e uzurpuar nga Sh. E. (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë). Ajo kishte nënshkruar Njoftimin e pjesëmarrjes duke pretenduar të drejtë ligjore mbi pronën kontestuese. Ajo pretendon se është bartëse e të drejtës pronësore të fituar në bazë të punësimit të bashkëshortit të saj në BDN. Prona e

kërkuar i ishte ndarë në shfrytëzim të përhershëm në vitin 1979 dhe e njëjta pronë është shfrytëzuar deri në vitin 1995.

4. Në mbështetje të drejtës së saj, pala përgjegjëse në ankesë paraqet dokumentet si në vijim:
  - Vendimin Nr.1545 të lëshuar me 10 Shtator 1979, nr.1545 nga Fabrika e Letrës dhe Ambalazhit “Stanoje Aksiç” në Lipjan, me të cilin këshilli i punëtorëve i kësaj fabrike i kishte ndarë për shfrytëzim pronën e kërkuar, I. E. në cilësinë e Drejtor Teknik,
  - Kontratën e shfrytëzimit Nr.1186 e datës 20 dhjetor 1979 e lidhur në mes të Ndërmarrjes Publike Banesore dhe I. E.,
  - Deklaratën e Drejtorit të BDN, të dhënë me datën 10 Shkurt 2001 ku ai konfirmon se, bashkëshortit të palës përgjegjëse në ankesë-I. E. i ishte ndarë prona e kërkuar në shfrytëzim të përhershëm me të drejtë të privatizimit,
  - Certifikatën e martesës Nr. 31/78 e datës 01 Gusht 2001 nga e cila dëshmohet se pala përgjegjëse në ankesë është bashkëshorte e I. E,
  - Aktgjykimin C.nr. 116/03 të datës 12 Maj 2003, me të cilin I. E., i ishte njohur e drejta e shfrytëzimit dhe pronësia mbi pronën e kërkuar.
5. Sipas Raportit të Verifikimit të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, Vendimi Nr.232, i datës 17 Maj 1995, me të cilat pala ankuese e mbështetë kërkesën e saj nuk ishte arrit të verifikohet pozitivisht.
6. Më 21 Tetor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës, me vendimin e vet KPCC/D/R/263/2014, vendosi që kërkesa të refuzohet, sipas arsytimit në paragrafin 29, ku theksohet se “paraqitësi i kërkesës të drejtën e saj e bazon mbi bazën e akomodimit të përkohshëm në pronën e kërkuar në bazë vendimit administrativ të vitit 1995. Paraqitësja e kërkesës dhe as Sekretaria Ekzekutive *ex officio*, nuk kanë arrit të sigurojnë dëshmi se e drejta e shfrytëzimit të përkohshëm, ishte përtërirë apo vazhduar nga organet kompetente.
7. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese me 29 Janar 2015. Më 27 Shkurt 2015, Pala Ankuese ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme.
8. Pala përgjegjëse në ankesë e ka pranuar ankesën e palës ankuese me 04 Dhjetor 2015. Me 29 Dhjetor 2015 dhe i është përgjigjur ankesës brenda afatit ligjor prej 30 ditë.

### **Pretendimet e Palës Ankuese**

9. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së, përmban shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
10. Sipas palës ankuese, ajo e ka të drejtën e bartësit të së drejtës banesore sepse në këtë banesë ka jetuar prej vitit 1995 e deri në qershor 1999, ndërsa për shkak të rrethanave të njohura është detyruar të largohet nga banesa dhe Kosova. Pala Ankuese thekson se asnjëherë nuk ka kërkuar të drejtën e pronësisë në banesën e kërkuar por vetëm të drejtën e shfrytëzimit ndërsa e kishte në plan për ta blerë pronën e kërkuar.

11. Në fund Pala Ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ankesa e saj të vendoset pozitivisht në dobi të saj, të priset vendimi i KKPK-së, dhe ti njihet e drejta e shfrytëzimit mbi banesën.

### **Pretendimet e Palës Përgjegjëse në Ankesë**

12. Pala përgjegjëse në ankesë, kryesisht i përsërit theksimet e saj si në shkallën e parë të KKPK-së, ndërsa pretendimet e Palës Ankuese i konteston si jo të qëndrueshme duke theksuar se e njëjta pas largimit nga puna të bashkëshortit të saj në mënyrë të pa ligjshme ia ka uzurpuar banesën, e cila i ishte ndarë në vitin 1979 nga Fabrika e Letrës dhe Ambalazhit “Stanoje Aksic”. Propozon që ankesa e Palës Ankueses të refuzohet si e pa bazuar ndërsa të vërtetohet vendimi i ankimuar i KKPK-së.

### **Arsyetimi ligjor:**

13. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh, siç është përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079, dhe është e pranueshme.

### **Meritat e ankesës**

14. Pas shqyrtimit të shkresave në dosje të lëndës, vendimit të kundërshtuar dhe pretendimeve të Palës Ankuese në përputhje me nenin 194 të LPK-së, Gjykata Supreme gjeti se vendimi i KKPK-së, duhet të anulohet jo për merita të ankesës e cila refuzohet si e pa bazuar, por *ex officio* pasi që kërkesa nuk bie në kuadër të juridiksionit të tij.
15. Nga përmbajtja e Vendimit të KKPK, pretendimeve të Palës Ankuese si dhe shkresave të tjera të lëndës, pa dyshim vërtetohet se prona e kërkuar nuk ishte pronë private por ishte pronë shoqërore ndërsa pronarë ishte Fabrika e Letrës dhe Ambalazhit “Stanoje Aksic” me seli në Lipjan. Pala Ankuese nuk ka pretenduar dhe nuk posedon dokumente se prona e kërkuar është privatizuar dhe këtë e pohon edhe në ankesë. Ajo kërkon që ti kthehet posedimi dhe e drejta e shfrytëzimit të banesës.
16. KKPK, në vendimin e saj e kishte refuzuar kërkesën e Palës Ankuese sipas arsyesimit se e njëjta nuk ka poseduar vendim në bazë të cilit do të konfirmohej ripërtërija apo vazhdimi i vendimit të përkohshëm për shfrytëzimin e banesës e cila i ishte ndarë për shfrytëzim me vendim të përkohshëm.
17. Nga këto fakte vërtetohet se e drejta e pretenduar për shfrytëzimin e pronës së kërkuar nuk ka të bëjë me pronë private ashtu si përshihet në nenin 3.1, të Ligjit Nr. 03/L-079. Sipas këtij neni KKPK-ja ka kompetencë të zgjidhë kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë mbi pronën private dhe kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtën e shfrytëzimit të pronës së pa luajtshme private.

18. Për më tepër sipas nenit 2.1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 mbi implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, në tekstin e mëtejme Urdhëresa Administrative (UA) “çdo person që ka pasur të drejtën pronësore, posedimin e ligjshëm apo çfarëdo të drejte të ligjshme në pronë të paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, i cili në kohën e parashtrimit të kërkesës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij pronësore për shkak të rrethanave drejtpërdrejtë të lidhura me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999, apo rrethanave që kanë rezultuar nga ai, ka të drejtë në rikthimin e së drejtës së tij në pronë, në cilësinë e poseduesit të së drejtës në pronë.
19. Prandaj Vendimi i KKKPK, është i pa qëndrueshëm dhe i njëjti prishet *ex officio*, me që lënda nuk bie kuadër të kompetencave të saj. KKKPK nuk është dashtë të vendosi çështjen në mënyrë meritore por është dashtë ta hedhë poshtë kërkesën ,si në kuptim të nenit 11.4 (a), të Ligjit nr.03/L-079. Me që KKKPK nuk ka vendosur në këtë mënyrë, nga kolegji vendimi kundërshtuar prishet *ex officio*, dhe kërkesa hidhet poshtë (argumenti sipas nenit 198.1,të Ligjit për Procedurën Kontestimore), i cili zbatohet *mutatis mutandis* ,për procedurën para kolegjit të apelit të Gjykatës Supreme, sipas nenit 12.2, të Ligjit nr.03/L-079.
20. Ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për pretenduesin apo poseduesin aktual të pronës së kërkuar, po ashtu nuk paraqet pengesë për inicim të procedurës pranë organit kompetent apo gjykatës kompetente për palët që e konsiderojnë të nevojshme.
21. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079, dhe nenin 198.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **Këshillë ligjore:**

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it**

**Ragip Namani, gjyqtar**

**Bjorn Olof Brautigam, referent i EULEX-it**